



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 1189/

Tirane, date 2.7.2015

Drejtuar: Z. ARJAN TARTARI
SHOQERIA "ALBAENERGJIPLUS" SH.P.K
RRUGA "MINE PEZA" NR.210/1/6

TIRANE

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z. RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1407 date 01.09.2009.

I nderuar z. Tartari,

Shoqëria "AlbaEnergjiaPlus" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1407 date 01.09.2009, për qymyr guri, vanadium, germanium, toka te rralla ne objektin "Mali i Molles", Qafe Priskë, ne Qarkun Tirane.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr. 2415 date 18.02.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.1189 date 18.02.2015, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimit nr.1406 date 01.09.2009, për qymyr guri, vanadium, germanium, toka te rralla, ne objektin "Mali i Molles", Qafe Priskë, ne Qarkun Tirane, për arsye se nuk është filluar nga puna ne objekt edhe pse kane kaluar rreth 6 vite nga data efektive e dhënies se lejes.

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

